



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:244750
Datë: 28.02.2024
Numri i dokumentit: 05389113

CA.nr.1086/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti – kryetare e kolegjit, Enes Mehmeti dhe Dardan Kadolli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesit propozuesit B.S., nga fshati S....., Komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson B.B., avokat nga Suhareka, kundër kundërshtarit të sigurimit Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me seli në Prishtinë, për masë të përkohshme të sigurimit, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të propozuesit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3887/2023 të datës 15.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.02.2024, mori këtë :

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e propozuesit B.S., nga fshati Sopijë, Komuna e Suharekës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3887/2023 të datës 15.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, C.nr.3887/2023 të datës 15.01.2024, ka vendosur si vijon:

“ **HEDHET** ankesa e propozuesit B.S., nga fshati S....., komuna e Suharekës, si e pasafatshme”.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i propozuesit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 126 të LPK-së, llogaritjes së afatit, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e propozuesit ta aprovoj si të bazuar, ndërsa aktvendimin e atakuar ta anuloj dhe ashtu që ankesa e propozuesit të konstatohet se është e paraqitur brenda afatit ligjor.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe analizimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se :

-Ankesa e propozuesit të masës, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se propozuesi i masës së përkohshme, përmes të autorizuarit të tij, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka parashtruar propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, ndaj kundërshtarit të sigurimit Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të pezullohet ekzekutimi i vendimit të komisionit të ankesave i Policisë së Kosovës datë 31.10.2023 me nr.XXX-KA-2023, deri në vendosjen meritore për padinë e cila do të paraqitet brenda afatit , konform këshillës juridike të vendimit të komisionit të ankesave.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin C.nr.3887/2023 të datës 16.11.2023, e ka hedhë poshtë propozimin e propozuesit si të palejuar, ndaj këtij aktvendimi propozuesi ka ushtruar ankesë, të cilën pastaj gjykata me aktvendimi e atakuar e ka hedhur si të paafatshme duke vendosur më decidivisht si në arsyetim të aktvendimit ankimor.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vepruar kur ka hedhur poshtë si të paafatshme ankesën e propozuesit të ushtruar ndaj aktvendimit C.nr.3887/2023 të datës 16.11.2023, kur ka konstatuar se ankesa është paraqitur pas kalimit të afatit kohor të dhënë në këshillën juridike të aktvendimit të atakuar prej 15 ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit në dorëzim të të njëjtit aktvendim nga propozuesi.

Sipas dispozitës së nenit 186 paragrafi 2 i LPK-së, përcaktohet se: *“Ankesa është e paafatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj”*, në rastin konkret propozuesi ankesën e ka paraqitur pas kalimit të afatit 15 ditor. Në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se propozuesi aktvendimin për hedhje të propozimit e ka pranuar me datën 01.12.2023, ndërsa ankesën e ka dorëzuar me postë me datë

19.12.2023, që vërtetohet nga vula e Postës së Kosovës në Suharekë. Nga kjo rezulton se ankesa është paraqitur pas skadimit të afatit të paraparë prej 15 ditëve, dita e fundit për paraqitjen e ankesës ka qenë data 18.12.2023, mirëpo i njëjti ankesën e ka paraqitur me 19.12.2023, pra pas skadimit të afatit për paraqitjen e ankesës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat, kjo gjykatë vlerësoj se duhet refuzuar si të pathemeltë ankesën e propozuesit dhe të vërtetohet aktvendimi i atakuar.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.1086/2024, me datë 27.02.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti d.v.